



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:142560

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708414

C.nr.531/21

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri duke vendosur në çështjen juridike të paditëses Z.G. nga fshati K./Malishevë, të cilën me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat nga Malisheva, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike “Kompensim për pagesën e shujtave”, vlera e kontestit 1,720.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 20.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e palejueshme** padia me numër C.nr.531/21 e datës 01.07.2021, e paditëses paditëses Z.G. nga fshati K./Malishevë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti “Kompensim për pagesën e shujtave”, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë (Litispendenca) lidhur me lëndën numër C.nr.1207/2021.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja paditëses Z.G. nga fshati K./Malishevë, mësimsdhënëse në SHFMU ”Dëshmorët e Fshatit Bubavec” në Bubavec/Malishevë, përmes të autorizuarit të saj Av. Agron Kryeziu, me datë 01.07.2021, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti Kompensim për pagesën e shujtave, vlera e kontestit 1,720.00 euro.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së palës paditëse, gjatë shqyrtimit paraprak të të njëjtës dhe duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare, nga shikimi në shkresat e lëndës ka konstatuar se për çështjen në fjalë ekziston gjyqvarësia (Litispendenca), pra lidhur me çështjen e njëjtë kontestuese pranë të njëjtës gjykatë është duke u udhëhequr procesi gjyqësor sipas lëndës C.nr.1207/2021, ose më saktësisht më herët është vendosur nga ana e kësaj gjykate me aktgjykimin numër C.nr.1207/2021 të datës 31.05.2023 dhe se lënda me ankesë gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Deri te konstatimi i tillë, gjykata erdhi pasi bëri vlerësimin e aktgjykimit të marrë nga kjo gjykatë të datës 31.05.2023 me shenjen C.nr.1207/2021, ku nga ky vendim konstatohet se i njëjti është marrë në çështjen kontestimore të paditëses paditëses Z.G.nga fshati K./Malishevë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës-Drejtoria e Arsimit, aktgjykim i cili objekt të çështjes kishte kompensimin e shujtave ditore, me vlerë të kontestit 1,720.00 euro.

Siç dihet, pas pranimit të padisë, gjykata duhet bërë shqyrtimin paraprak të saj, dhe nëse gjatë shqyrtimit paraprak konstatohet se për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqvarësia (Litispendenca), atëherë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme, kjo është paraparë edhe me nenin 391 pika c) ku theksohet se: *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: c) “për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca)”*.

Në dispozitën e nenit 262 par.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se: *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”*, kurse në paragrafin 4 në po të njëjtin nen thuhet: *“Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta”*.

Duke u ndodhur në një situatë të tillë, dhe pas konstatimit se në po të njëjtën gjykatë është krijuar gjyqvarësia, pra meqenëse të dyja çështjet paraqesin objektin e njëjtë, palët e njëjta dhe periudhën e njëjtë kohore, gjykata vlerëson se nuk mund të hyjë ta shqyrtojë çështjen, dhe këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika c) të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 262 par.3 dhe 4 lidhur me nenin 391 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.531/21, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.